

Formular për SYLLABUS të Lëndës: Metodatat statistikore në marketing

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik
Titulli i lëndës:	Metodat statistikore në marketing
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti i tretë, Semestri i V
Numri i orëve në javë:	2L+1U
Vlera në kredi – ECTS:	4 ECTS
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënës të lëndës:	Prof. Dr. Rahmije Mustafa Topxhiu
Përshkrimi i lëndës	Kursi ofron një rishikim të përgjithshëm të metodave statistikore për analizën e të dhënave të ndryshme në fushën e hulumtimit të tregut dhe studimit të tregut. Temat e mëposhtme diskutohen gjithashtu: Menaxhimi i të dhënave (Mbledhja, burimi dhe llojet e të dhënave, etj); Metodatat e anketimit; Dizajnimet e pyetësorit; Shpërndarjet teorike probabilitare; Shpërndarjet probabilitare të variablave diskrete; Shpërndarja normale dhe shpërndarja normale standarde; Intervalet e besimit; Testimi i rëndësisë përmes hipotezave; Analiza e Korrelacionit Linear; Regresionit linear; Regresioni dhe korrelacioni i shumëfishtë.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i këtij kursi është t'u ofrojë studentëve njohuri teorike dhe aftësi praktike nga metodatat statistikore që mund të përdoren në fushën e hulumtimit të tregut dhe studimit të tregut. Pas përfundimit të lëndës, studenti fiton njohuri teorike, aftësi praktike dhe është në gjendje t'i zbatojë ato në përgatitjen e anketave dhe pyetësorëve, në analizën statistikore të të dhënave të grumbulluara, në interpretimin e rezultateve në mbështetje të vendimmarrjes.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të kursit studentët do të jenë në gjendje që të: <ul style="list-style-type: none"> - Kuptojnë rolin dhe rëndësinë e analizës statistikore për marrjen e vendimeve në sfera të ndryshme ekonomike, shoqërore dhe personale, e me theks te veçante në marketing. - Shpjegojnë se si të dhënat janë përzgjedhur, mbledhur dhe paraqitur duke përdorur një sërë treguesish përmbledhës; - Demonstrjnë se si teknikat e mbuluara në kurs mund të përdoren për të ndihmuar në analizën dhe zgjidhjen e problemeve në fushën e tregut dhe studimit të tregut. - Aplikojnë shpërndarjet probabilitare të ndërprera dhe të vazhdueshme për të llogaritur probabilitetet; - Vlerësojnë parametrat e tërësisë së përgjithshme përmes intervalit të besimit dhe testimit të hipotezave;

	- Vlerësojnë sa e fortë është marrëdhënia midis dy ose më shumë ndryshoreve dhe të parashikojnë efektin e ndryshimit në një variabël në një variabël të tjerë.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	2	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	1	15
Punë praktike	-	-	5
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	6	6
Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokviume, seminare	-	-	-
Detyra të shtëpisë	3	11	20
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	8	10
Përgaditja përfundimtare për provim	-	-	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	3	6
Projektet, prezentimet ,etj	-	-	3
Totali			105
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Për të arritur një nivel të kënaqshëm të mësim nxënies efektive, do të përdoren metoda të kombinuara të mësimdhënies në mënyrë të balancuar me qëllim që të përmbushen kriteret e të nxënit. Fillimisht do të përcaktohen qartë objektivat mësimore si dhe studentëve do t'u sqarohet shumë qartë se çfarë pritet prej tyre. Gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve do të përdoret mësim aktiv me qëllim që të mbahet gjallë vëmendja e studentëve gjatë orës së mësimit duke iu dhënë atyre në mënyrë të herëpashershme për të bërë ushtrime në grupe të vogla. Pasi të jenë formuar grupet, atyre do tu shtrohen pyetje ose do të vihet në diskutim një problem i shkurtër të cilin ata duhet ta zgjidhin ose të dhënë përgjigje në pyetjet e parashtruara. Duke marrë pjesë në mënyrë aktive në diskutimet në klasë dhe në kryerjen e detyrave në klasë, çdo student do të përmirësojë komunikimin dhe aftësitë analitike nëpërmjet të mësuarit të koncepteve statistikore dhe aplikimeve të tyre në biznes dhe ekonomi. Duke plotësuar detyrat e shtëpisë, çdo student do të rrisë aftësitë analitike, si dhe do të përmirësojë aftësitë dhe shkathhtësitë duke përdorur Microsoft Excel për futjen e të dhënave dhe analizën e tyre.</p>		
Metodat e vlerësimit:	Studentët do të vlerësohen gjatë gjithë semestrit dhe		

	<p>gjithashtu me një provim përfundimtar duke zbatuar shpërndarjen e mëposhtme të vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja aktive: 5%; - Seminar me përdorim të dhënave : 10%; - Detyrat e shtëpisë 10% - Test 1: 10%; - Test 2: 10% - Provimi final 55% <p>Kriteret e dhënies së provimit janë të bazuara në Vendimin e Këshillit të Fakultetit të prezantuar në Raportin e Vetëvlerësimit.</p>	
Literatura		
Literatura bazë:	Rahmije Mustafa - Topxhiu: <i>HYRJE NË STATISTIKË</i> , Prishtinë, 2016	
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> - Prem S. Man, <i>Introductory Statistics</i>, Seventh Edition, John Wiley & Sons, 2010, USA, - Douglas A. Lind. William G. Marchal, Samuel A. Wathen, (2013), <i>Basic Statistics for Business & Economics</i>, Eighth Edition, McGraw-Hill/Irwin, International Edition, New York. - David R. Anderson, Dennis J. Sweeney, Thomas A. Williams, (2013), <i>Statistika për biznes dhe ekonomik</i>, UET press, Tiranë. - Milan Papiq, <i>Statistika e aplikuar në MS Excel</i>, (2007) përkthim nga kroatishtja, Kolegji Universitar “Victory”. Prishtinë. 	
Plani i dizajnuar i mësimit:	Libri : Hyrje në Statistikë	Faqe
Java	Ligjërata që do të zhvillohet	
<i>Java e 1^{re}:</i>	Hyrje (Prezantimi i lëndës, Metodatat e punës dhe vlerësimit; Obligimet e dyanshme student-mësimdhënës).	
<i>Java e 2^{te}:</i>	<i>Kapitulli 1.</i> Menaxhimi i të dhënave (Përmbledhja, burimet, llojet e të dhënave, etj.);	19-61
<i>Java e 3^{te}:</i>	<i>Kapitulli i 8.</i> Metodatat e zgjedhjes/mostrës dhe Pyetësorët	319-347
<i>Java e 4^{te}:</i>	<i>Kapitulli 3 dhe 4.</i> Statistika deskriptive –përshkruese (matësit e tendencës qendrore dhe variacionit).	121-189
<i>Java e 5^{te}:</i>	<i>Kapitulli 5.</i> Një vështrim mbi konceptet bazë të probabilitetit.	195-242
<i>Java e 6^{te}:</i>	<i>Kapitulli 6.</i> Variablat e rastit dhe modelet e shpërndarjeve probabilitare- Shpërndarjet probabilitare të ndërprera.	243-275
<i>Java e 7^{te}:</i>	<i>Kapitulli 7.</i> Shpërndarjet probabilitare të vazhdueshme- Shpërndarja normale dhe shpërndarja standarde normale	279 -315
<i>Java e 8^{te}:</i>	<i>Kapitulli 9.</i> Shpërndarjet probabilitare të mostrave.	347-380
<i>Java e 9^{te}:</i>	<i>KOLLOKVIUMI I PARË</i>	

<i>Java e 10^{-te}:</i>	<i>Kapitulli 10. Vlerësimi dh intervalet e besueshmërisë për mesataren aritmetike të popullacionit.</i>	383-404
<i>Java e 11^{-te}:</i>	<i>Kapitulli 10. Vlerësimi dhe intervalet e besueshmërisë për përpjesën e popullacionit.</i>	405-423
<i>Java e 12^{-te}:</i>	<i>Kapitulli 11. Testimi i hipotezave rreth parametrave të popullimit I.</i>	425-458
<i>Java e 13^{-te}:</i>	<i>Kapitulli 11. Testimi i hipotezave rreth parametrave të popullimit II.</i>	460-490
<i>Java e 14^{-te}:</i>	<i>Kapitulli 12. Analiza e regresioni dhe korrelacionit</i>	497-527
<i>Java e 15^{-te}:</i>	<i>Kapitulli 12. Analiza e regresioni dhe korrelacionit</i>	526-557
<i>Java e 16^{-te}:</i>	KOLLOKVIUMI I DYTË	

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

- Pjesëmarrja e rregullt dhe aktive në ligjërata dhe në ushtrime;
- Respektimi i orarit të ligjëratave dhe ushtrimeve.
- Ç'kyçja e telefonave celular dhe mbajtja e qetësisë në mësim.